

QYTETI I SHKUPIT

Në përputhje me nenin 4 të Rregullores për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për subvencionimin e qytetarëve në territorin e Qytetit të Shkupit për blerjen e trotinetit elektrik në vitin 2019 nr. 08-6185/1 të datës 25.06.2019, dhe në lidhje me Vendimin për përcaktimin e vlerës maksimale për dhënien e subvencionit individual për qytetarët në territorin e Qytetit të Shkupit në vitin 2019 („Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” nr. 02/19, nr. 08/19), Qyteti i Shkupit shpall

THIRRJE PUBLIKE për subvencionimin e qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për blerjen e trotineteve elektrike në vitin 2019

1. Përshkrimi i thirrjes publike

1.1. Qyteti i Shkupit, me qëllim që të stimulojë banorët e qytetit të Shkupit për përdorimin e trotineteve elektrike, qytetarëve që do të blejnë trotinet elektrik të ri në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga data 01.01.2019 deri në shterimin e buxhetit të dedikuar për Thirrjen publike, ose jo më vonë se 30.11.2019, do t'u kompensojë një pjesë të shpenzimeve të bëra gjatë blerjes së trotinetit elektrik.

1.2. Mjetet që Qyteti i Shkupit do t'i subvencionojë janë në vlerën prej 30% të vlerës së trotinetit, por jo më shumë se 7.000,00 denarë për person, me tatim mbi të ardhurat personale të përfshirë.

1.3. Thirrja publike do të realizohet sipas parimit „i pari i ardhur, i pari shërbehet “

2. E drejta për pjesëmarrje në Thirrje publike

Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë banorët e Qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Butel, Gazi Baba, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisela Voda, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare), të cilët do të blejnë trotinet të ri në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga data 01.01.2019 deri në shterimin e buxhetit të dedikuar për Thirrjen publike, ose jo më vonë se 30.11.2019 dhe të cilët plotësojnë kushtet e kësaj Thirrjeje publike.

3. Kushte që duhet të plotësojë aplikuesi

Aplikuesi duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të jetë banor i Qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Butel, Gazi Baba, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisela Voda, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare),
- deri tani nuk ka shfrytëzuar subvencion për blerjen e trotinetit elektrik nga Qyteti i Shkupit,
- trotineti i ri elektrik të jetë blerë në Republikën e Maqedonisë së Veriut duke u llogaritur nga data 01.01.2019 deri në shterimin e buxhetit të dedikuar për Thirrjen publike, por jo më vonë se 30.11.2019.

4. Mënyra e aplikimit në Thirrjen publike

4.1. Për kompensimin e një pjese të shpenzimeve dhe për të konfirmuar se kushtet për pjesëmarrje në Thirrjen publike janë plotësuar, aplikuesi pranë Qytetit të Shkupit duhet të dorëzojë:

- Kërkesë për subvencionim për blerjen e trotinetit elektrik të ri (Kërkesa mund të merret nga arkivi i Qytetit të Shkupit ose të sigurohet nga faqja e internetit e Qytetit: www.skopje.gov.mk),
- dëshmi për vendbanim në Shkup, me dorëzimin e kopjes së kartës së identitet të vlefshme të aplikuesit,
- fotokopje e llogarisë së transaksionit të aplikuesit,
- deklaratë që aplikuesi deri tani nuk ka shfrytëzuar subvencion për blerjen e trotinetit elektrik nga Qyteti i Shkupit,
- llogari fiskale origjinale e lëshuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nga data 01.01.2019 deri në shterimin e buxhetit të dedikuar për Thirrjen publike, por jo më vonë se 30.11.2019.

4.2. Një person mund të dorëzojë vetëm një kërkesë për marrjen e subvencionit për blerjen e një trotineti elektrik

4.3. Kërkesat për subvencionimin e qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për blerjen e trotineteve elektrike në vitin 2019, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm, qytetarët në zarf të mbyllur i dorëzojnë pranë Komisionit përkatës, nëpërmjet Arkivit të Qytetit të Shkupit, bul. Ilinden nr. 82, çdo ditë pune nga ora 09:00 deri në orën 15:00.

4.4. Në zarf duhet të shënohet “Thirrje publike për subvencionimin e qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për blerjen e trotineteve elektrike në vitin 2019”

4.5. Arkivi i Qytetit të Shkupit kërkesat e pranuar do t'i evidentojë me kohën e saktë të dorëzimit (data, ora dhe minuta), për shkak të vendosjes së renditjes sipas së cilës do të shqyrtohen kërkesat.

5. Mënyra e realizimit të Thirrjes publike

5.1. Për realizimin e Thirrjes publike Kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komision për realizimin e Thirrjes publike për subvencionimin e qytetarëve të qytetit të Shkupit për blerjen e trotineteve elektrike në vitin 2019.

5.2. Qyteti i Shkupit në varësi të dinamikës së arritjes së aplikacioneve, në mënyrë periodike do të njoftojë publikun për mjetet e mbetura, deri në shfrytëzimin e plotë të tyre, por jo më vonë se 30.11.2019.

5.3. Pagimi i mjeteve do të kryhet në mënyrë të njëpasnjëshme, sipas renditjes së aplikimeve të arritura, deri në plotësimin e buxhetit të parashikuar për këtë qëllim.

5.4. Nëse mjetet financiare të parashikuara janë shterur, Qyteti i Shkupit do të shpallë përfundimin e Thirrjes publike nëpërmjet ueb faqes së tij. Mjetet financiare do të konsiderohen si të shterura përkatësisht të ndara kur me propozim të komisionit, Kryetari i Qytetit do të sjellë aktvendim për pagimin e mjeteve.

6. Mënyra e realizimit të së drejtës së kompensimit

(1) Kryetari i Qytetit të Shkupit në bazë të Propozimit të komisionit sjell aktvendim për miratimin e Kërkesës për subvencionimin e qytetarëve në territorin e Qytetit të Shkupit për blerjen e trotineteve elektrike

(2) Komisioni njofton aplikuesit të cilët nuk kanë plotësuar kushtet e Thirrjes publike për refuzimin e kërkesës së tyre.